

Rregullat e shtëpisë

Qëllimi: Rregullat e shtëpisë ndihmojnë për të pasur një bashkëjetesë të mirë dhe janë ndihmesë për të siguruar mirëkuptim ndaj njëri – tjetrit.

1. Detyrat e shtëpisë:

- 1.1. Është e rëndësishme që shtëpia të jetë e pastër dhe që të krjohet një ambient i mirë.
- 1.2. Detyrat e shtëpisë janë obligim dhe të përmushen sipas planit dhe në afat të caktuar.

2. Ushqimi:

- 2.1. Ne vlerësojmë një strukturë të shëndoshë të ushqimit.
- 2.2. Kohët për ushqim janë të obliguara dhe prania në tavolinë të ushqimit është obligim. (Përveç në raste kur dikush është i sëmurë).
- 2.3. Ushqimi dhe pijet nuk lejohen në dhomat e katit të dytë.
- 2.4. Të shërbyerit vetë nga bodrumi dhe kuzhina është i ndaluar.
- 2.5. Shërbimi i kafes është i caktuar dhe lejohen dy kafe në ditë.

3. Higjiëna:

- 3.1. Secili obligohet të kujdeset për higjiën personale.
- 3.2. Kjo do të ndihmojë për të pasur një ambient të mirë të bashkëjetesës.
- 3.3. Higjiëna në kuzhinë dhe në banjo gjithashtu.
 - 3.3.1. Kjo vlen edhe si masë preventive për sëmundje ngjitëse.

4. Dhomat:

- 4.1. Pastrimi i dhomës, ku edhe pjesëmarrësi flen, është obligim i tij.
- 4.2. Rregullimi i dhomave lejohet sipas dëshirës së pjesëmarrësit.
 - 4.2.1. Mirëpo mund të ndalohen pikturat të cilat mund të kenë një ndikim negativ tek banuesi.
- 4.3. Mbyllja e dhomave me çelës nuk lejohet.
- 4.4. Stafit në çdo kohë i lejohet të mbikqyrë dhomat.

5. Telefonat:

- 5.1. Nuk lejohet posedimi i një celulari.
 - 5.1.1. Secila thirrje që ka nevojë të realizohet për të biseduar në radhë të parë duhet konsultuar me stafin i cili është në detyrë.
 - 5.1.2. Stafit vendosë pastaj se a duhet lejuar ajo thirrje a jo.
- 5.2. Numri i bisedave në telefon rregullohet sipas arritjeve në programin terapisë së.
- 5.3. Në muajin e parë të terapisë nuk lejohen thirrjet. (shiko Programin e Terapisë)

6. Posta:

- 6.1. Posta e cila vjen në qendër pranohet vetëm nga stafi.
- 6.2. Letrat për pjesëmarrësit hapen vetëm në prani të kujdestarit personal.

7. Televizori:

- 7.1. Televizor do të ketë vetëm në dhomën e përbashkët.
- 7.2. Televizor lejohet të shikohet sipas programit ditor.
- 7.3. Nëpër dhoma nuk lejohet të ketë televizor.
- 7.4. Filma apo programe që nuk përshtaten me etikën e qendrës nuk lejohen.

8. Muzika:

- 8.1. Dëgjimi i muzikës lejohet vetëm në dhomën e ditës dhe vetëm jashtë orarit e punës.
- 8.2. Volumi i zërit të radios lejohet vetëm vetëm aq sa është e caktuar nga stafi në atë mënyrë sa të mos pengohen të tjerët.
- 8.3. Lejohen vetëm radio ose CD-të e Strehës.

9. Orari:

- 9.1. Për të zhvilluar programin sa më mirë, secili të mundohet të jetë i saktë në orar.
- 9.2. Ankesat e bazuara rezultojnë me dënime.

10. Pushimi:

- 10.1. Kohët e pushimit duhet të respektojë që secili që ka nevojë për të pushuar të mos pengohet.
- 10.2. Pas orës 22.00 është pushimi i natës.
- 10.3. Pjesëmarrësit shkojnë nëpër dhomat e tyre dhe hiket të gjitha dritat.

11. Financat:

- 11.1. Mbajtja e parave nuk lejohet. Vetëm në rastet si në vijim.
 - 11.1.1. Kur del në qytet.
 - 11.1.2. Kur gjatë daljes blenë cigare.
 - 11.1.3. Kur gjatë daljes, pin kafe apo han ushqim.
- 11.2. Paratë që shokët apo familjarët ua sjellin i dorëzohen stafit.
- 11.3. Menaxhimi i parasë bëhet në kordinim dhe bashkpunim me sfatin dhe pjesëmarrësin.

12. Vizitat:

- 12.1. Vizita e parë nga familjet pas muajit të katër.
- 12.2. Vizitat nga ana e familjarëve apo shokëve lejohen vetëm nëse paraprakisht është informuar stafi në mënyrë që të aprovohet ose jo.
- 12.3. Mysafirëve nuk u lejohet pirja e duhanit apo e alkoolit përgjatë kohës kur janë prezent në qendër. Kjo gjë në parim duhet sqaruar nga ana e pjesëmarrësve/banorëve të qendrës në raport me mysafirët.
- 12.4. Vendi ku prahen mysafirët përcaktohet nga stafi.
- 12.5. Mysafirëve nuk i lejohet për të shetituar në krejt shtëpinë.
- 12.6. Qëndrimi i mysafirëve lejohet vetëm në katin e parë. (Përfshirë vetëm për t'iu treguar dhomën në pajtimin me cimerin.)

13. Dalja jashtë qendrës:

- 13.1. Nuk lejohet në asnjë mënyrë pa u konsultuar më parë me stafin.
- 13.2. Çdo dalje rregullohet në mënyrë individuale dhe sipas Programit të Terapisë.

14. Droga:

- 14.1. Ndalohet rreptësisht posedimi i gjwrave narkotike në qendër apo në arealin e qendrës.
- 14.2. Çfarëdo shkelje e mundshme mund të dënohet me përfshirje të menjëheshme dhe padiskutim nga terapia.

15. Duhan:

- 15.1. Pirja e duhanit lejohet vetëm jashtë shtëpisë.
- 15.2. Në muajin e parë 5 në ditë.
- 15.3. Në muajin e dytë 3 cigare në ditë.
- 15.4. Cigaret duhet të blejë vet pjesëmarrësi.

16. Sigurimi:

- 16.1. Thika apo gjëra të tilla pjesëmarrësve nuk u lejohet në asnjë mënyrë.
- 16.2. Gjëra të tilla dorëzohen në fillim të terapisë.
- 16.3. Paisjet të cilat shkatërrohen me qëllim nga pjesëmarrësi, ato do të kompenzohen nga financat e pjesëmarrësitë.

17. Qirinjtë e ndezur nëpër dhoma lejohen vetëm kur stafi është nënjohuri dhe jo pas orës 22.00.

18. Mbi të gjitha këto rregulla qëndron **RESPEKTI** për njëri-tjetrin.

19. Shkeljet e këtyre rregullave do të dënohen. Dënimet janë në mënyrë individuale.